



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 18 (827974)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 8 maj 2026



Nga Besëlidhja te Pavarësia, nga lufta te paqja, dëshmorët mbeten drita e kombit

» faqe 3,10



5 MAJI

Në një atmosferë solemniteti, respekti dhe përlësie kombëtare, Shqipëria përkujtoi 5 Majin – Ditën e Dëshmorëve të Atdheut, një nga datat më domethënëse të historisë shqiptare, kushtuar atyre që dhanë jetën për lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e vendit. Në Varrezat e Dëshmorëve, drejtuesit më të lartë të shtetit shqiptar zhvilluan homazhe dhe vendosën kurora me lule në nderim të të rënëve për atdheun. Në ceremoninë shtetërore morën pjesë Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, Kryeministri Edi Rama, Zv. Kryetarja e Kuvendit, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtnant Arben Kingji. Në ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu familjarë...

faqe 3



25 VITE PARTNERITET / SHQIPËRI – GARDA KOMBËTARE E NEW JERSEY-IT, NJË MIQËSI STRATEGJIKE E NDËRTUAR MBI BESIM, SIGURI DHE VLERA TË PËRBASHKËTA

Në një atmosferë solemniteti, mirënjohjeje dhe miqësie të konsoliduar ndër vite, në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia përkujtimore me rastin e 25-vjetorit të partneritetit ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it, një bashkëpunim që gjatë një çerek shekulli është shndërruar në një nga modelet më të suksesshme të partneritetit strategjik ushtarak mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ceremonia...

faqe 4



NGA SAKRIFICA NË PËRJETËSI: AMANETI I HASAN RAKIPIT DHE RRUGËTIMI I VAJZËS SË TIJ

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në historinë e një kombi ka momente që nuk maten me kohë, por me sakrificë. Lufta Nacional Çlirimtare mbetet një nga ato kapituj të paharrueshëm, ku mijëra bijë e bija të Shqipërisë vendosën fatin e tyre përmbi fatin e atdheut. Ata nuk kërkuar lavdi, por liri, nuk menduan për jetën e tyre, por për të ardhmen e brezave që do të vinin më pas. Sot, kur kujtojmë...

faqe 8

Në kuadër të 25-vjetorit të partneritetit ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it, Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar delegacionin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, të kryesuar nga Gjeneral Brigade Yvonne L. Mays.

Takimi u zhvillua në frymën e miqësisë së ngushtë dhe partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke vënë theksin tek bashkëpunimi i shkëlqyer 25-vjeçar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjatë bisedimeve, u vlerësua kontributi i rëndësishëm që Garda Kombëtare e New Jersey-it ka dhënë ndër vite në drejtim të rritjes së profesionalizmit, modernizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura shqiptare.

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara dhe për partneritetin e konsoliduar me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, duke theksuar se ky bashkëpunim ka ndikuar drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve operationale, trajnuese dhe ndërvepruese të FA-së shqiptare.

Ai rikonfirmoi gjithashtu gatishmërinë e Shqipërisë për të thelluar më tej partneritetin strategjik me SHBA-në, në funksion të paqes, sigurisë dhe përmbushjes së angazhimeve të përbashkëta në kuadër të NATO-s.

Nga ana e tij, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit ndërmjet dy forcave, duke evidentuar rëndësinë e trajnimeve të përbashkëta, shkëmbimit të eksperiencave dhe mbështetjes amerikane në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare.

Gjeneral Brigade Yvonne L. Mays shprehu vlerësimin për marrëdhëniet e shkëlqyera me Shqipërinë dhe për profesionalizmin e efektivëve shqiptarë, duke theksuar se partneriteti me Forcat e Armatosura shqiptare mbetet një model i suksesshëm bashkëpunimi në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror.

Takimi riafirmoi edhe njëherë marrëdhëniet e forta strategjike mes Shqipërisë dhe SHBA-së, si dhe angazhimin e përbashkët për forcimin e sigurisë, stabilitetit rajonal dhe bashkëpunimit në kuadër të Aleancës Atlantike.



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dhe SHSHHPFA gjenerallejtënant Arben Kingji pritën delegacionin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it



Tirana mirëpriti zhvillimin e Takimit të 26-të të Komitetit Rajonal të Kërkim-Shpëtimit Aeronautik (RASARAC), një aktivitet me rëndësi të veçantë për bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë ajrore dhe operationeve të kërkim-shpëtimit.

Në këtë takim morën pjesë ekspertë të fushës së aviacionit dhe kërkim-shpëtimit nga vendet e rajonit, si dhe partnerë ndërkombëtarë, të cilët diskutuan mbi sfidat, praktikatat më të mira dhe nevojën për forcimin e koordinimit ndërkufitar në raste emergjencash ajrore.

Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes mori pjesë zëvendësministria Blerina Abrazhda, e cila vlerësoi rëndësinë e këtij forumi si një platformë të rëndësishme bashkëpunimi dhe shkëmbimi profesional ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

- Gjatë punimeve të takimit, pjesëmarrësit u fokusuan në:
- **Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në operationet e kërkim-shpëtimit;**
 - **Forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar;**
 - **Rritjen e kapaciteteve operationale dhe koordinuese në fushën e sigurisë ajrore;**
 - **Avancimin e mekanizmave të reagimit të shpejtë në situata emergjente.**

Në fjalën e saj, zëvendësministria Blerina Abrazhda theksoi angazhimin e Shqipërisë për të garantuar standarde të larta sigurie në hapësirën ajrore dhe për të kontribuar aktivisht në mekanizmat rajonalë të bashkëpunimit.

Ajo nënvizoi se sfidat moderne në fushën e aviacionit civil dhe ushtarak kërkojnë koordinim të vazhdueshëm, shkëmbim informacioni dhe rritje të kapaciteteve profesionale ndërmjet vendeve partnere.

“Shqipëria mbetet e përkushtuar për të mbështetur dhe avancuar iniciativat e përbashkëta rajonale që synojnë rritjen e sigurisë ajrore dhe shpëtimin e jetëve



Shqipëria mikpriti Takimin e 26-të të Komitetit Rajonal të Kërkim-Shpëtimit Aeronautik (RASARAC)



njerëzore”, - u shpreh ajo gjatë takimit.

Takimi i 26-të i RASARAC u vlerësua si një hap i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e kërkim-shpëtimit aeronautik, duke kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve më të avancuara dhe në përmirësimin e reagimit të koordinuar ndaj emergjencave ajrore.

Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të standardizimit të procedurave operationale, në përputhje me praktikatat dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë ajrore.

Përmes organizimit të këtij aktiviteti, Shqipëria riafirmoi rolin e saj aktiv në nismat rajonale të sigurisë dhe bashkëpunimit, si dhe angazhimin për të kontribuar në garantimin e një mjedisi ajror më të sigurt dhe më të koordinuar për të gjithë rajonin.

5 MAJI Shqipëria përulet me nderim para dëshmorëve të kombit

Në një atmosferë solemniteti, respekti dhe përulësie kombëtare, Shqipëria përkujtoi 5 Majin – Ditën e Dëshmorëve të Atdheut, një nga datat më domethënëse të historisë shqiptare, kushtuar atyre që dhanë jetën për lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e vendit.

Në Varrezat e Dëshmorëve, drejtuesit më të lartë të shtetit shqiptar zhvilluan homazhe dhe vendosën kurora me lule në nderim të të rënëve për atdheun. Në ceremoninë shtetërore morën pjesë Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, Kryeministri Edi Rama, Zv. Kryetarja e Kuvendit, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji.

Në ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu familjarë të dëshmorëve, veteranë të Luftës Nacional Çlirimtare, përfaqësues të institucioneve shtetërore, efektivë të Forcave të Armatosura, studentë, të rinj dhe qytetarë të shumtë që iu bashkuan nderimit për ata që sakrifkuan jetën për Shqipërinë.

Një ditë e shenjtë e kujtesës kombëtare

5 Maji nuk është thjesht një datë kalendarike. Për shqiptarët ajo mbetet dita e kujtesës së përhershme, dita kur kombi ndalet për të reflektuar mbi çmimin e lirisë dhe mbi sakrificat që kanë ndërtuar themelet e shtetit shqiptar.

Që prej shpalljes së kësaj dite si Dita e Dëshmorëve, shqiptarët kujtojnë jo vetëm luftëtarët e rënë në Luftën Nacional Çlirimtare, por të gjithë ata burra dhe gra që në periodha të ndryshme historike vunë jetën në shërbim të atdheut.

Ceremonia në Varrezat e Dëshmorëve nisi me ekzekutimin e himnit kombëtar dhe me nderimet ushtarake të Gardës së Republikës. Në heshtjen solemne që mbuloi kompleksin memorial, drejtuesit e shtetit vendosën kurora me lule pranë monumentit “Nëna Shqipëri”, simbolit të sakrificës dhe krenarisë kombëtare.

Tingujt ceremonialë ushtarakë dhe ulja e flamujve në gjysmëshkëlqim krijuan një atmosferë të veçantë emocionale, ku kujtesa historike dhe respekti për të rënë u bashkuan në një akt të madh nderimi kombëtar.

Presidenti Begaj: Dëshmorët janë themeli moral i kombit

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, në mesazhin e tij vlerësoi figurën e dëshmorëve si simbolin më të lartë të sakrificës për lirinë dhe identitetin kombëtar.

Ai theksoi se çdo brez ka detyrimin moral dhe qytetar të ruajë kujtesën historike dhe të mbrojë vlerat për të cilat luftuan dëshmorët, sakrifica e tyre mbetet një amanet për Shqipërinë moderne, një thirrje për bashkim, përgjegjësi dhe përkushtim ndaj interesit kombëtar.

“Nuk ka komb të fortë pa kujtesë historike. Dëshmorët tanë janë rrënja morale e shtetit shqiptar dhe frymëzim i përhershëm për brezat që ndërtojnë të ardhmen e vendit”, - u shpreh Presidenti Begaj gjatë ceremonisë përkujtimore.

Ai nënvizoi gjithashtu rolin e Forcave të Armatosura shqiptare si trashëgimtare të traditës patriotike dhe të sakrificës së brezave që luftuan për lirinë e Shqipërisë.

Kryeministri Rama: Liria është ndërtuar mbi sakrificë

Kryeministri Edi Rama e cilësoi 5 Majin si një ditë reflektimi kombëtar, ku Shqipëria përkulet me mirënjohje para të gjithë atyre që vendosën fatin e atdheut mbi jetën personale.

Ai theksoi se dëshmorët nuk kërkuar lavdi personale, por luftuan për të ardhmen e vendit dhe për brezat që do të vinin më pas, kujtesa për dëshmorët duhet të mbetet e gjallë jo vetëm në monumente dhe ceremoni, por edhe në përkushtimin e përditshëm për ndërtimin e një Shqipërie më të drejtë, më demokratike dhe më të zhvilluar.

“Çdo brez duhet të dijë se liria nuk është dhuratë. Ajo është fituar me gjak, me sakrificë dhe me vetëmohim. Dëshmorët mbeten ndërgjegjja më e pastër e kombit shqiptar”, - u shpreh Kryeministri Rama.

Ministri i Mbrojtjes Nufi: Trashëgimia e dëshmorëve jeton në Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, vlerësoi rëndësinë e kësaj dite për institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Ai theksoi se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbajnë me krenari trashëgiminë patriotike të dëshmorëve dhe vijnë në shërbim të vendit, të paqes dhe të sigurisë, sakrifica e të rënëve mbetet frymëzim për



çdo ushtarak shqiptar dhe për çdo të ri që zgjedh t'i shërbejë atdheut me dinjitet dhe përgjegjësi.

“Dëshmorët na kanë lënë jo vetëm kujtimin e tyre, por edhe detyrimin për të mbrojtur Shqipërinë, për të ruajtur paqen dhe për të forcuar institucionet demokratike të vendit”, - deklaroi ai.

Gjenerallejtënant Arben Kingji: Sakrifica e tyre është akti më i lartë i shërbimit ndaj kombit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, u shpreh se kujtimi i dëshmorëve mbetet pjesë e pandashme e identitetit dhe traditës së ushtrisë shqiptare.

Ai vlerësoi sakrificën e të rënëve si aktin më sublim të shërbimit ndaj atdheut dhe theksoi se Forcat e Armatosura shqiptare vazhdojnë të ndërtohen mbi vlerat e patriotizmit, disiplinës dhe përkushtimit.

Homazhe në të gjithë vendin

Përveç ceremonisë qendrore në Tiranë, homazhe dhe aktivitete përkujtimore u zhvilluan në të gjithë Shqipërinë.

Në qytete, fshatra dhe memoriale të dëshmorëve, pushteti vendor, organizatat e veteranëve, familjet e dëshmorëve, nxënës dhe qytetarë vendosën lule dhe zhvilluan aktivitete

përkujtimore në nderim të të rënëve.

Në shumë shkolla u organizuan orë përkujtimore dhe aktivitete edukative për të transmetuar tek brezat e rinj historinë e sakrificës dhe luftës për liri.

Veteranët e Luftës Nacional Çlirimtare dhe familjarët e dëshmorëve kujtuan me emocion bashkëluftëtarët dhe të afërmit e tyre, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike.

Amaneti i dëshmorëve

Në çdo 5 Maj, Shqipëria rikujton se liria, pavarësia dhe sovraniteti nuk janë fituar lehtë. Pas tyre qëndrojnë histori sakrifice, dhimbjeje, heroizmi dhe dashurie të pakushtëzuar për atdheun. Dëshmorët mbeten ndër figurat më të ndritura të historisë kombëtare shqiptare. Ata janë simbol i rezistencës, i dinjitetit dhe i shpirtit të pamposhtur të shqiptarëve ndër shekuj. Përmes ceremonive, homazheve dhe kujtesës kolektive, kombi shqiptar riafirmon çdo vit se sakrifica e tyre nuk do të harrohet kurrë.

5 Maji mbetet kështu jo vetëm një ditë nderimi, por edhe një thirrje për përgjegjësi qytetare, për unitet kombëtar dhe për ndërtimin e një Shqipërie që respekton historinë, vlerat dhe amanetin e dëshmorëve të saj.



25 VITE P PARTNERITET

Shqipëri - Garda Kombëtare e New Jersey-it,

një miqësi strategjike e ndërtuar mbi besim, siguri dhe vlera të përbashkëta

Në një atmosferë solemniteti, mirënjohjeje dhe miqësie të konsoliduar ndër vite, në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia përkujtimore me rastin e 25-vjetorit të partneritetit ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it, një bashkëpunim që gjatë një çerek shekulli është shndërruar në një nga modelet më të suksesshme të partneritetit strategjik ushtarak mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ceremonia mbledhi drejtues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura, përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë, ushtarakë shqiptarë dhe amerikanë, veteranë, studentë dhe të ftuar të shumtë, të cilët vlerësuan këtë rrugëtim 25-vjeçar si një histori të suksesshme bashkëpunimi, profesionalizmi dhe partneriteti strategjik.

Një partneritet që nisi me besim dhe u forcua me kohën

Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it nisi në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, menjëherë pas viteve të transformimit demokratik të Shqipërisë.

Në këto 25 vite, ky partneritet ka luajtur një rol të rëndësishëm në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare, në rritjen e kapaciteteve operacionale, në trajnimin e personelit ushtarak dhe në forcimin e standardeve profesionale sipas kriterëve të NATO-s.

Nga trajnimet e përbashkëta, shkëmbimet profesionale, stërvitjet shumëkombëshe, menaxhimi i emergjencave civile dhe deri tek mbështetja në edukimin ushtarak, Garda Kombëtare e New Jersey-it ka qenë një partner i rëndësishëm në rrugëtimin euroatlantik të Shqipërisë.

Në fjalët përshëndetëse gjatë ceremonisë, drejtuesit ushtarakë shqiptarë dhe përfaqësuesit amerikanë vlerësuan partneritetin si një urë të fortë miqësie dhe bashkëpunimi mes dy vendeve.

U theksua se marrëdhëniet Shqipëri-SHBA nuk janë thjesht marrëdhënie aleate, por një lidhje e ndërtuar mbi vlera të përbashkëta demokratike, besim reciprok dhe angazhim për paqen dhe sigurinë globale.

Forcat e Armatosura shqiptare, pjesë aktive e partneritetit strategjik

Në këtë 25-vjetor u evidentua kontributi i rëndësishëm që ky partneritet ka dhënë në transformimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Përmes bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të New



Jersey-it, efektivet shqiptarë kanë përfutur eksperiencë të vyer profesionale në fusha të ndryshme si operacionet paqeruajtëse, logjistika, mbrojtja civile, siguria kibernetike, menaxhimi i krizave dhe reagimi ndaj emergjencave.

Ky partneritet ka ndihmuar gjithashtu në rritjen e ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura shqiptare me strukturat e NATO-s dhe me forcat aleate amerikane, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike.

Në aktivitet u theksua se Shqipëria mbetet një partner i besueshëm i SHBA-së dhe NATO-s, ndërsa bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të New Jersey-it konsiderohet një nga shtyllat më të rëndësishme të kësaj marrëdhënieje strategjike.

Java Amerikane, festë e vlerave, historisë dhe kulturës amerikane

Në kuadër të Javës Amerikane, aktivitetet vijuan edhe



në Bibliotekën Kombëtare “Sotir Koele” në Tiranë, ku u çel ekspozita e veçantë e Muzeut të Themeluesve.

Ekspozita paraqet portrete dhe biografi të 13 nënshkruesve të Deklaratës së Pavarësisë së SHBA-së, nga secila prej 13 kolonive origjinale amerikane, duke sjellë për publikun shqiptar një rrugëtim historik mbi themelimin e kombit amerikan dhe lindjen e idealeve të lirisë dhe demokracisë.

Në ceremoninë e hapjes, e ngarkuara me punë e SHBA-së në Shqipëri, Nancy VanHorn, solli në vëmendje faktin se Shtetet e Bashkuara shënojnë këtë vit 250-vjetorin e Pavarësisë.

Në fjalën e saj, ajo theksoi rëndësinë e vlerave mbi të cilat u ndërtua shteti amerikan dhe miqësinë e qëndrueshme mes popullit amerikan dhe shqiptar.

“Gjatë kësaj jave kemi ftuar miqtë dhe partnerët tanë shqiptarë të bashkohen me ne për të nderuar vlerat amerikane dhe për të festuar arritjet amerikane në kulturë, histori dhe sport. Thomas Jefferson dhe Benjamin Franklin ishin njerëz me prejardhje të ndryshme, por ndanin një ideal të përbashkët: lirinë”, - u shpreh VanHorn.



Ekspozita sjell gjithashtu momente kyçe historike që çuan drejt themelimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe evidenton qytete si Bostoni, Nju Jorku dhe Filadelfia, ku jetojnë komunitete të mëdha shqiptaro-amerikane.

Një element interesant i ekspozitës ishte edhe përdorimi i teknologjisë së realitetit virtual, duke u dhënë vizitorëve mundësinë të përfjetojnë në mënyrë interaktive historinë amerikane.

Muzika si urë miqësie mes dy popujve

Në vazhden e aktiviteteve të Javës Amerikane, Këndi Amerikan në Tiranë mirëpriti grupin muzikor “Flagship” të Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara në Europë dhe Afrikë. Artistët amerikanë performuan së bashku me muzikantë të rinj shqiptarë, në një aktivitet artistik që solli jo vetëm muzikë, por edhe mesazhe bashkëpunimi, lirie dhe komunikimi kulturor. Përmes interpretimit të traditave muzikore amerikane dhe shqiptare, aktiviteti tregoi se arti dhe muzika mbeten gjuhë universale që bashkojnë popujt përtej kufijve politikë apo gjeografikë.

Të rinjtë shqiptarë patën mundësinë të bashkëpunojnë nga afër me muzikantët amerikanë, duke shkëmbyer eksperiencën artistike dhe kulturore në një atmosferë miqësore dhe frymëzuese.

Mbrëmja gala e 7 majit, simbol i miqësisë Shqipëri-SHBA

Kulmi i aktiviteteve të Javës Amerikane u shënua në mbrëmjen e 7 majit me një aktivitet të madh kulturor dhe artistik, organizuar me mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Qendrës së Kulturës, Mediave, Botimeve të Mbrojtjes.

Big Band-i QKMBM dhe Banda Amerikane performuan së bashku në një koncert të veçantë artistik, duke përcjellë përmes muzikës mesazhin e bashkëpunimit, partneritetit dhe miqësisë së fortë mes dy vendeve.

Koncerti solli në skenë interpretime të njohura të muzikës amerikane dhe shqiptare, të cilat u mirëpritën me entuziazëm nga publiku i pranishëm.

Atmosfera festive dhe emocionale tregoi edhe njëherë se marrëdhëniet Shqipëri-SHBA shkojnë përtej diplomacisë dhe bashkëpunimit ushtarak; ato janë marrëdhënie të ndërtuara edhe mbi lidhje njerëzore, kulturore dhe historike.

Një partneritet për të ardhmen

25-vjetori i partneritetit mes Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it nuk ishte thjesht një përvjetor ceremonial, por një dëshmi konkrete e forcës së marrëdhënieve mes dy vendeve.

Në një botë me sfida të shumta sigurie dhe transformime të vazhdueshme gjeopolitike, bashkëpunimi strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA-së mbetet një garanci e rëndësishme për stabilitetin, paqen dhe sigurinë rajonale.

Ky partneritet vazhdon të jetë një investim i përbashkët në sigurinë, profesionalizmin dhe të ardhmen euroatlantike të Shqipërisë, ndërsa miqësia mes dy popujve mbetet një nga asetet më të çmuara të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane.

Në përmbyllje të Javës Amerikane, aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura, Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, si dhe partnerët amerikanë, dëshmuar edhe njëherë se marrëdhëniet Shqipëri-SHBA nuk ndërtohen vetëm mbi partneritetin strategjik dhe bashkëpunimin ushtarak, por edhe mbi kulturën, artin dhe vlerat e përbashkëta njerëzore.

Performanca e përbashkët artistike mes Big Band-it shqiptar dhe Bandës Amerikane solli një atmosferë miqësie, harmonie dhe bashkëpunimi, duke e kthyer muzikën në një urë komunikimi mes dy popujve dhe dy aleatëve të qëndrueshëm. Përmes tingujve të muzikës, u përcoll mesazhi se partneriteti Shqipëri-SHBA mbetet një histori suksesi që vazhdon të forcohet çdo ditë, në shërbim të paqes, sigurisë dhe miqësisë së përhershme mes dy vendeve.





Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi priti Drejtorin për Paqen, Partneritetet dhe Menaxhimin e Krizave në EEAS

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, priti në një takim zyrtar Drejtorin për Paqen, Partneritetet dhe Menaxhimin e Krizave në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), z. Cosmin Dobran.

Takimi u zhvillua në kuadër të dialogut të vazhdueshëm ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke konfirmuar angazhimin e përbashkët për forcimin e partneritetit strategjik dhe bashkëpunimit euroatlantik.

Gjatë bisedimeve, palët vlerësuan Partneritetin për Siguri dhe Mbrojtje si një platformë praktike dhe efektive për bashkëpunim të strukturuar, në funksion të adresimit të sfidave të përbashkëta të sigurisë dhe menaxhimit të krizave.

Ministri Ermal Nufi theksoi se Shqipëria mbetet plotësisht e fokusuar në vazhdimin e këtij dialogu dhe në arritjen e rezultateve konkrete në fushat me interes të përbashkët, duke evidentuar rolin aktiv të vendit tonë si kontribuues për sigurinë rajonale dhe evropiane.

Ai nënvizoi gjithashtu se Shqipëria mbetet një partner i besueshëm për sigurinë evropiane dhe një aleat i përkushtuar në kuadër të NATO-s, duke kontribuar në forcimin e stabilitetit dhe paqes në rajon dhe më gjerë.

Në takim u diskutua mbi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe NATO-s, veçanërisht në përbashkëtimin e sfidave të reja të sigurisë, krizave hibride, mbrojtjes kibernetike dhe menaxhimit të emergjencave.



Nga ana e tij, z. Cosmin Dobran vlerësoi rolin aktiv të Shqipërisë në nismat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, si dhe angazhimin e vazhdueshëm të vendit tonë në misionet dhe operacionet e përbashkëta të BE-së dhe NATO-s.

Takimi riafirmoi vullnetin e përbashkët për të forcuar më tej bashkëpunimin strategjik mes Shqipërisë, Bashkimit Evropian dhe Aleancës Atlantike, në funksion të garantimit të sigurisë, stabilitetit dhe paqes në hapësirën euroatlantike.



Kursantët e KLSM-16, vizitë studimore në Mbretërinë e Belgjikës

Në kuadër të programit mësimor dhe të rritjes së kapaciteteve profesionale, pjesëmarrësit e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-16) po zhvillojnë një vizitë studimore në Belgjikë, me fokus njohjen nga afër me strukturat ushtarake dhe civile të NATO-s dhe proceset strategjike të sigurisë dhe mbrojtjes.

Vizita drejtohet nga Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Altin Kurti dhe përfshin takime me përfaqësues të lartë të institucioneve aleate dhe strukturave ndërkombëtare të sigurisë.

Gjatë qëndrimit në Belgjikë, kursantët po njihen nga afër me mekanizmat e vendimmarrjes strategjike, menaxhimin e krizave, planifikimin operacional dhe funksionimin e strukturave të NATO-s në kuadër të sigurisë kolektive dhe mbrojtjes euroatlantike.

Takimet me ekspertë dhe drejtues të strukturave ushtarake dhe civile të Aleancës shërbejnë si një mundësi e rëndësishme për shkëmbimin e eksperiencave profesionale dhe për thellimin e njohurive mbi sfidat bashkëkohore të sigurisë.

Aktiviteti synon të kontribuojë në rritjen profesionale të kursantëve të KLSM-16, në zhvillimin e aftësive drejtuese dhe strategjike, si dhe në forcimin e ndërveprueshmërisë me partnerët dhe strukturat aleate të NATO-s.

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, vlerësoi rëndësinë e këtyre vizitave studimore në përgatitjen e kuadrove të larta civile dhe ushtarake, duke theksuar se njohja direkte me institucionet ndërkombëtare të sigurisë përbën një element të rëndësishëm në formimin profesional dhe strategjik të tyre.

Vizita studimore në Mbretërinë e Belgjikës konsiderohet një hap i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit me strukturat aleate dhe në përgatitjen e specialistëve dhe drejtuesve të ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Përmes aktiviteteve të tilla, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë vijon të konsolidojë rolin e tij në përgatitjen e kapaciteteve drejtuese, në funksion të forcimit të sigurisë kombëtare dhe kontributit të Shqipërisë në strukturat euroatlantike.



Forca Ajrore rrit kapacitetet mirëmbajtëse përmes bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të New Jersey-it

Në Bazën Ajrore Farkë, në kuadër të trajnimit të përbashkët “Aviation Maintenance Q3”, të zhvilluar mes Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe ekipit të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, u shënua një moment i rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve teknike dhe operacionale të aviacionit ushtarak shqiptar.

Për herë të parë, personeli teknik shqiptar realizoi punimet e nivelit të dytë, 480-orëshe dhe 4-vjeçare në helikopterin UH-60 “Black Hawk”, një proces kompleks mirëmbajtjeje që përfshin inspektimin e thelluar dhe kontrollin e plotë të të gjitha sistemeve të mjetit ajror.

Punimet u kryen nga specialistët shqiptarë të mirëmbajtjes së Forcës Ajrore, me mbështetjen dhe mbikëqyrjen e ekspertëve amerikanë të atashuar në vend, si dhe me kontributin profesional të ekipit të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Ky proces konsiderohet një hap i rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve teknike të Forcës Ajrore shqiptare, duke rritur aftësitë për mirëmbajtje të avancuar të mjeteve ajrore sipas standardeve të NATO-s.

Trajnimi “Aviation Maintenance Q3” synon jo vetëm transferimin e njohurive teknike dhe praktikave bashkëkohore të mirëmbajtjes, por edhe rritjen e ndërveprueshmërisë mes forcave shqiptare dhe partnerëve amerikanë në kuadër të bashkëpunimit strategjik dhe angazhimeve të përbashkëta në Aleancën Atlantike.

Gjatë zhvillimit të punimeve, specialistët shqiptarë dhe amerikanë punuan në mënyrë të integruar në kontrollin teknik të sistemeve avionike, motorike, hidraulike dhe strukturale të helikopterit UH-60, duke garantuar standarde të larta sigurie dhe efieciencë operacionale.

Drejtuesit ushtarakë vlerësuan profesionalizmin e personelit teknik shqiptar dhe rëndësinë që ka ky bashkëpunim për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të aviacionit ushtarak shqiptar.

U theksua se realizimi i këtyre inspektimeve të avancuara nga vetë personeli shqiptar përbën një arritje të rëndësishme për Forcën Ajrore, duke rritur pavarësinë operacionale dhe gatishmërinë teknike të flotës ajrore.

Bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të New Jersey-it vijon të mbetet një ndër shtyllat kryesore të partneritetit strategjik Shqipëri-SHBA në fushën e mbrojtjes, duke kontribuar në modernizimin e Forcave të Armatosura dhe në forcimin e kapaciteteve profesionale të personelit ushtarak shqiptar.

Ky trajnim dëshmon edhe njëherë angazhimin e përbashkët për rritjen e standardeve të sigurisë, profesionalizmit dhe gatishmërisë operacionale të Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë në përputhje me kërkesat dhe standardet e NATO-s.



Forcim i bashkëpunimit dhe mbështetje për studentët e Kosovës në AFA dhe KMS

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes të Shqipërisë dhe Kosovës, studentët nga Kosova që ndjekin studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) dhe në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) u bënë pjesë e një takimi të veçantë me delegacionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të kryesuar nga zëvendësministri i Mbrojtjes së Kosovës, z. Gegë Lleshi.

Delegacioni kosovar, i shoqëruar nga zëvendësministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, znj. Pranvera Skana, u prit në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura nga Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj.

Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe vëllazërore, duke përcjellë mesazhe të qarta mbi rëndësinë e bashkëpunimit strategjik ndërmjet dy vendeve, veçanërisht në fushën e edukimit ushtarak, formimit profesional dhe mbështetjes së brezit të ri të ushtarakëve shqiptarë nga Kosova.

Gjatë bashkëbisedimit me studentët, përfaqësuesit e institucioneve të mbrojtjes vlerësuan angazhimin dhe përkushtimin e tyre në rrugën e formimit akademik dhe ushtarak, duke theksuar se investimi tek të rinjtë mbetet një investim i drejtpërdrejtë për sigurinë, stabilitetin dhe të ardhmen e përbashkët kombëtare.

Zëvendësministri i Mbrojtjes së Kosovës, Gege Lleshi, shprehu mirënjohjen për mbështetjen që institucionet shqiptare të mbrojtjes u japin studentëve nga Kosova, duke e cilësuar këtë bashkëpunim si një urë të rëndësishme në forcimin e lidhjeve ndërmjet dy vendeve dhe në ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta profesionale dhe strategjike.

Nga ana e saj, zëvendësministri Pranvera Skana theksoi se Shqipëria dhe Kosova ndajnë jo vetëm vlera të përbashkëta kombëtare, por edhe objektiva të njëjta në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke nënvizuar rëndësinë e edukimit ushtarak cilësor dhe bashkëpunimit institucional.

Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, evidentoi rolin që AFA dhe KMS luajnë në përgatitjen e kuadrove të rinj ushtarakë, duke garantuar standarde bashkëkohore akademike dhe profesionale në përputhje me kërkesat e NATO-s dhe sfidat e sigurisë moderne. Takimi u vlerësua si një dëshmi konkrete e marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet



Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe edukimit ushtarak, si dhe një inkurajim i rëndësishëm për studentët që kanë zgjedhur t'i shërbejnë kombit përmes profesionit ushtarak. Përmes këtij bashkëpunimi, institucionet e



mbrojtjes të të dy vendeve riafirmojnë angazhimin për të investuar tek brezi i ri, për të forcuar partneritetin strategjik dhe për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme për të gjithë shqiptarët.

Ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIX EOD drejt misionit të NATO-s, në Letoni

Në ambientet e Batalionit të Xhenios u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIX EOD, i cili do të përfaqësojë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në kuadër të misionit të Forcës së Përparuar Tokësore të NATO-s në Riga, Letoni.

Ceremonia u zhvillua në një atmosferë solemne dhe krenarie ushtarake, në praninë e drejtuesve të Forcave të Armatosura, efektivëve të Batalionit të Xhenios, familjarëve të ushtarakëve si dhe përfaqësuesve të institucioneve të mbrojtjes.

Kontingjenti shqiptar do t'i bashkohet Brigadës Shumëkombëshe Letoneze, duke kontribuar në operacionet dhe detyrat në fushën e neutralizimit të mjeteve shpërthyes (EOD – Explosive Ordnance Disposal), një ndër komponentët më të rëndësishëm të sigurisë operationale në misionet ndërkombëtare.

Efektivët e kontingjentit janë përgatitur sipas standardeve të NATO-s dhe do të angazhohen në operacione që lidhen me identifikimin, çaktivizimin dhe neutralizimin e mjeteve shpërthyes, duke kontribuar drejtpërdrejt në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Gjatë ceremonisë u vlerësua profesionalizmi, përkushtimi dhe niveli i lartë i gatishmërisë së trupave shqiptare, të cilat prej vitesh japin kontribut të rëndësishëm në misionet ndërkombëtare të Aleancës Atlantike. Drejtuesit ushtarakë theksuan se pjesëmarrja e Forcave të Armatosura shqiptare në misionet e NATO-s mbetet një dëshmi konkrete e angazhimit të Shqipërisë si vend aleat, kontribuues aktiv për paqen, sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar.

Në fjalët përshëndetëse u nënvizua gjithashtu rëndësia strategjike e pranisë së forcave shumëkombëshe në krahun lindor të NATO-s, në kuadër të masave të përforcuara të mbrojtjes kolektive dhe sigurisë euroatlantike. Kontingjenti XIX EOD konsiderohet një tjetër dëshmi e kapaciteteve profesionale që Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ndërtuar



ndër vite në fushën e xhenios dhe neutralizimit të mjeteve shpërthyes, duke u bërë një faktor i rëndësishëm përkrah vendeve aleate në përmbushjen e detyrave operationale.

Në përfundim të ceremonisë, efektivët e kontingjentit iu urua sukses në përmbushjen e misionit, kthim të sigurt në atdhe dhe vijimësi në përfaqësimin dinjitoz të flamurit shqiptar në operacionet ndërkombëtare të NATO-s.



NGA SAKRIFICA NË PËRJETËSI:

Amaneti i Hasan Rakipit dhe rrugëtimi i vajzës së tij



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në historinë e një kombi ka momente që nuk maten me kohë, por me sakrificë. Lufta Nacional Çlirimtare mbetet një nga ato kapituj të paharrueshëm, ku mijëra bijë e bija të Shqipërisë vendosën fatin e tyre përmbi fatin e atdheut.

Ata nuk kërkuan lavdi, por liri, nuk menduan për jetën e tyre, por për të ardhmen e brezave që do të vinin më pas. Sot, kur kujtojmë ata që ranë për këtë tokë, nuk përkujtojmë vetëm një histori, por një amanet që na është lënë për ta ruajtur dhe për ta çuar përpara.

Mes këtyre figurave qëndron edhe dëshmori Hasan Xhafer Rakipi, një djalë i ri që jetoi me ideale të mëdha dhe që e vulosi jetën e tij me aktin më të lartë të sakrificës. Historia e tij nuk është vetëm një rrëfim trimërie, por një dëshmi e një brezi që e deshi atdheun më shumë se veten.

Por historia nuk mbaron me rënien e dëshmorëve. Ajo vazhdon të jetojë tek familjet e tyre, tek fëmijët që u rritën me mungesën, por edhe me krenarinë. Një prej tyre është edhe vajza e tij, Filloreta Zaçe, e cila, edhe pse nuk pati fatin ta njohë babanë, ka arritur ta mbajë gjallë frymën dhe vlerat e tij përmes jetës dhe veprës së saj.

Kjo intervistë vjen si një rrëfim i ndjerë, jo vetëm për të kujtuar një dëshmor, por për të kuptuar se si sakrifica e djeshme shndërrohet në përgjegjësi të sotme. Përmes fjalëve të saj, zbulojmë jo vetëm historinë e një familjeje, por edhe vazhdimësinë e një ideali që nuk shuhet me kohën.

“Pa Babë, por me Atdhe”

Zonja Filloreta, duke u nisur nga historia e babait tuaj, si e përjetoni sot figurën e tij në jetën tuaj personale dhe në ndërgjegjen tuaj si qytetare?

Figura e babait tim është një prani e përhershme në jetën time, edhe pse fizikisht nuk kam pasur fatin ta njoh. Ai nuk është thjesht një kujtim familjar, por një shtyllë morale mbi të cilën është ndërtuar gjithë formimi im si njeri. Kam jetuar gjithmonë me ndjesinë se mbaj mbi vete një emër që kërkon dinjitet, përgjegjësi dhe përkushtim.

Përmes rrëfimeve të nënës sime dhe njerëzve që e kanë njohur, kam krijuar një figurë të plotë të tij, një njeri i drejtë, i guximshëm dhe i palëkundur në bindjet e tij.

Në jetën time të përditshme, ai është një udhërrëfyes i heshtur. Në çdo vendim që marr, në çdo sfidë që përballem, përpiqem të mendoj se si do të kishte vepruar ai. Kjo më ka ndihmuar të jem më e fortë, më e drejtë dhe më e përkushtuar ndaj vlerave që ai përfaqësonte.

Duke qenë se keni qenë vetëm 6-muajshe kur ai ra dëshmor, si është ndërtuar kjo lidhje shpirtërore kaq e fortë me të?


Lidhja ime me babanë është ndërtuar përmes dashurisë dhe sakrificës së nënës sime, e cila ka qenë një grua jashtëzakonisht e fortë. Ajo nuk na rriti me ndjenjën e mungesës, por me ndjenjën e krenarisë. Na tregonte për babanë jo me dhimbje, por me respekt dhe admirim.

Gjithashtu, komuniteti ku jam rritur ka luajtur një rol të rëndësishëm. Respekti që njerëzit kishin për babanë tim më bëri të kuptoj që ai nuk ishte vetëm i imi, por i gjithë shoqërisë. Kjo më ka dhënë forcë dhe më ka ndihmuar të ndërtoj një lidhje shpirtërore shumë të fortë me të.

Çfarë ju është treguar për karakterin dhe jetën e Hasan Rakipit, si gjatë luftës ashtu edhe pas saj?

“Trashëgimia nuk është vetëm kujtim, por përgjegjësi për të vepruar”

Intervistë me znj. Filloreta Zaçe,
vajza e dëshmorit Hasan Rakipi



Babai im ka qenë një njeri shumë i përkushtuar ndaj idealeve të tij. Gjatë Luftës Nacional Çlirimtare ai u dallua për guximin dhe vendosmërinë, duke marrë pjesë aktive në luftimet për çlirimin e vendit. Por ajo që më bën më shumë përshtypje

është fakti që edhe pas luftës ai nuk u tërhoq nga përgjegjësitë. Ai u angazhua në ndërtimin e jetës së re, në organizimin e punës në fshat dhe në zhvillimin e komunitetit. Ishte një njeri që besonte se liria nuk mbaron me çlirimin, por vazhdon me



Figura e babait tim është një prani e përherëshme në jetën time, edhe pse fizikisht nuk kam pasur fatin ta njoh. Ai nuk është thjesht një kujtim familjar, por një shtyllë morale mbi të cilën është ndërtuar gjithë formimi im si njeri. Kam jetuar gjithmonë me ndjesinë se mbaj mbi vete një emër që kërkon dinjitet, përgjegjësi dhe përkushtim.

ndërtimin e një shoqërie më të drejtë. Kjo e bën figurën e tij edhe më të plotë.

Si e përjetoni sot sakrificën e tij, duke ditur se ai la pas një familje të re?

Është një ndjenjë shumë e thellë dhe komplekse. Ka dhimbje, sepse çdo fëmijë ka nevojë për babanë e tij. Ka mungesë, që ndihet sidomos në momente të rëndësishme të jetës. Por mbi të gjitha ka krenari.

Babai im nuk zgjodhi rrugën e lehtë. Ai zgjodhi detyrën, zgjodhi të mbrojtë vendin dhe njerëzit e tij. Kjo sakrificë më ka mësuar se jeta nuk matet me sa gjatë jeton, por me atë që lë pas.

Ju keni ndërtuar një jetë të angazhuar në shërbim të njerëzve, si në profesionin tuaj në ‘bluzën e bardhë’ ashtu edhe në aktivitetin shoqëror. Sa lidhet kjo me trashëgiminë e babait tuaj?

Lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Unë e kam parë gjithmonë jetën time si një vazhdim të asaj që ai përfaqësonte. Si infermiere, kam pasur mundësinë të jem pranë njerëzve në momentet më të vështira të

jetës së tyre. Kjo punë kërkon jo vetëm profesionalizëm, por edhe ndjeshmëri dhe përkushtim të madh njerëzor. Çdo pacient për mua ka qenë një përgjegjësi dhe një mundësi për të bërë diçka të mirë. Kam punuar me përkushtim, duke mos e parë kurrë punën si detyrim, por si mision. Besoj se kjo është një nga mënyrat më të drejtpërdrejta për të nderuar figurën e babait tim.

Përveç profesionit, ju keni qenë shumë aktive në organizata dhe aktivitete shoqërore. Mund të na flisni më gjerësisht për këtë kontribut?

Po, aktiviteti im shoqëror ka qenë një pjesë shumë e rëndësishme e jetës sime. Kam qenë e angazhuar në organizatat e familjeve të dëshmorëve dhe të veteranëve, ku kam kontribuar në organizimin e aktiviteteve përkujtimore dhe në ruajtjen e vlerave historike.

Kam mbajtur role drejtuese dhe organizative, duke u përpjekur të sjell një frymë bashkëpunimi dhe përkushtimi. Një nga qëllimet kryesore ka qenë përfshirja e të rinjve, që ata të mos ndihen të shkëputur nga kjo histori, por ta kuptojnë dhe ta respektojnë atë.

Si e shihni rolin tuaj si trashëgimtare e kësaj fryme

patriotike?

E shoh si një detyrë dhe përgjegjësi të madhe. Nuk është e mjaftueshme të jesh bijë dëshmori në kuptimin formal. Duhet të jesh aktive, të japësh shembull dhe të kontribuosh në shoqëri.

Unë jam përpjekur që përmes punës sime, si në profesion ashtu edhe në aktivitetin shoqëror, të ruaj dhe të përcjell këtë frymë. Besoj se çdo brez ka detyrën e vet për ta mbajtur gjallë këtë trashëgimi.

Sa i rëndësishëm është për ju transmetimi i kësaj historie tek brezat e rinj?

Është jetike. Nëse nuk e transmetojmë këtë histori, rrezikojmë të humbasim një pjesë të rëndësishme të identitetit tonë. Brezat e rinj duhet të dinë se liria që gëzojmë sot është fituar me shumë sakrifica.

Unë jam përpjekur gjithmonë të jem pranë tyre, të flas, të ndaj histori dhe të nxis respektin për të kaluarën. Vetëm kështu mund të ndërtojmë një të ardhme më të ndërgjegjshme.

Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje nga rrëfimet për natën kur babai juaj ra dëshmor?

Vendosmëria e tij për të mos u tërhequr. Ai ishte ndër të parët që doli përballë rrezikut, duke marrë mbi vete një përgjegjësi të madhe. Nuk mendoi për veten, por për detyrën. Kjo më ka bërë gjithmonë të reflektoj mbi guximin dhe mbi atë që do të thotë të jesh i përkushtuar ndaj idealeve.

Nëse do të kishit mundësi t’i drejtoheshit sot babait tuaj, çfarë do t’i thoshit?

Do t’i thosha që sakrifica e tij nuk ka shkuar dëm. Që ne jemi përpjekur dhe vazhdojmë të përpiqemi të jemi të denjë për të. Do t’i thosha që jemi krenarë dhe që ai mbetet një dritë udhëzuese në jetën tonë.

Çfarë mesazhi keni për shoqërinë shqiptare sot?

Të mos harrojmë. Të mos lejojmë që historia të zbehet apo të deformohet. Të punojmë me ndershmëri dhe përkushtim për vendin tonë. Vetëm duke respektuar të kaluarën mund të ndërtojmë një të ardhme më të mirë.

Trashëgimia e dëshmorëve nuk është vetëm kujtim, është detyrim për të jetuar me dinjitet, për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe për të mos harruar kurrë sakrificat mbi të cilat është ndërtuar liria jonë.

**“Hija që Nuk u Shua” –
Elegji për Dëshmorin Hasan Rakipi**

Në fshatin ku era ende flet me gurët, një emër endet si kambanë e largët: Hasan Rakipi.
Nuk erdhi me kurorë mbi ballë,
as me trumbetat e lavdisë.
Erdhi siç vijnë burrat e vërtetë: heshtur, me natën në sy, Shqipërinë në krahavor.
Ishte kohë kur toka kërkonte gjak që të mbinte liria.
Dhe ai e dha.
Pa bërë marrëveshje me vdekjen, pa pyetur sa pranvera do t’i mungonin fëmijëve të tij.
Në atë natë të errët, kur pushkët ndiznin malet si vetëtimat të zemëruara, ai doli përpara si një lis që nuk di të përkulet.
Pas tij mbeti një foshnjë gjashtëmuajshe, një grua me sytë e ngjirë nga pritja, dhe një amanet që koha nuk arriti ta tresë.
Sot, nëpër rrugët ku ecin njerëzit e zakonshëm, hija e tij kalon ende.
E shohin pleqtë në heshtje, e ndiejnë fëmijët pa e njohur, sepse dëshmorët kanë një mënyrë të çuditshme për të mos vdekur kurrë.
Dhe vajza e tij, Filloreta, mban në duar jo vetëm kujtimin, por një pishtar të vjetër lufte që nuk shuhet. Në bluzën e bardhë të shërbimit, në fjalën e mirë, në përkuljen para dhimbjes njerëzore, ajo vazhdon betejën e të atit me armë të tjera: dashurinë, dinjitetin, kujtesën.
Sepse atdheu nuk mbahet vetëm me pushkë. Mbahet edhe me zemra që nuk harrojnë.
Dhe një komb humbet jo atëherë kur i bien heronjtë, por atëherë kur harron emrat e tyre.
Prandaj, sa herë flamuri valëvitet në erë, dikush duhet të kujtojë se e kuqja e tij nuk erdhi nga përëndimi i diellit...

Kjo intervistë i kushtohet dëshmorit Hasan Rakipi dhe të gjithë bijve e bijave që vazhdojnë të mbajnë gjallë frymën e tyre përmes punës, përkushtimit dhe dashurisë për atdheun.

5 MAJI - DITA QË NA MAT SI KOMB

Nga themeli i lirisë te përgjegjësia e sotme, dëshmorët si ndërgjegje e përhershme e Shqipërisë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në kalendarin e një kombi ka data që shënojnë ngjarje dhe ka data që përcaktojnë identitet. 5 Maji është ndër ato pak ditë që nuk i përkasin vetëm historisë, por ndërgjegjes kolektive. Është dita kur Shqipëria ndalet jo për të parë pas me nostalgji, por për të kuptuar më thellë çmimin e lirisë. Një ditë që nuk kërkon vetëm kujtim, por kërkon reflektim dhe përgjegjësi.

Dëshmorët e Atdheut nuk janë thjesht pjesë e së shkuarës. Ata janë standardi moral me të cilin matet e tashmja dhe projektohet e ardhmja.

DËSHMORËT, THEMELI I SHTETIT DHE I LIRISË

Në çdo analizë serioze të historisë shqiptare, një fakt mbetet i pakundërshtueshëm: shteti shqiptar është ndërtuar mbi sakrifica njerëzore. Dëshmorët nuk janë vetëm figura simbolike, por aktorë realë të proceseve historike që kanë garantuar mbijetesën dhe konsolidimin e kombit.

Lufta Nacionalçlirimtare përbën një nga kulmet e kësaj sakrifice. Ajo nuk ishte vetëm një përplasje ushtarake, por një mobilizim i përgjithshëm shoqëror, ku individë nga çdo shtresë vendosën të vënë jetën në shërbim të lirisë. Dëshmorët e kësaj periudhe nuk përfaqësojnë vetëm një epokë, por një filozofi: **bindjen se liria nuk dhurohet, por fitohet.**

Por rëndësia e tyre nuk qëndron vetëm në aktin e sakrificës. Ajo që i bën dëshmorët të përjetshëm është mesazhi që ata lënë pas: një mesazh uniteti, përkushtimi dhe përgjegjësie ndaj atdheut.

RREZIKU I HARRESËS DHE DEBATET E SË SOTMES

Në shoqëritë moderne, një nga sfidat më të mëdha nuk është mungesa e informacionit, por mënyra si ai interpretohet. Historia shpesh bëhet objekt debatesh të nxehta, interpretimeve selektive dhe, në raste të caktuara, deformimesh të qëllimshme.

Edhe në Shqipëri, Lufta Nacionalçlirimtare dhe figura e dëshmorëve kanë qenë subjekt i diskutimeve të forta. Kjo është pjesë e një procesi normal demokratik, por rreziku lind kur relativizimi i historisë kalon në mohimin e sakrificës.

Dëshmorët nuk janë ideologji. Ata janë njerëz që dhanë jetën. Dhe sakrifica njerëzore nuk mund të relativizohet pa cenuar vetë bazën morale të shoqërisë.

5 Maji na kujton se, pavarësisht interpretimeve, ekziston një e vërtetë themelore: pa ata që ranë, Shqipëria nuk do të ishte kjo që është sot.

VIJIMËSIA E SAKRIFICËS, NGA LUFTA TE MISIONET MODERNE

Një nga gabimet më të zakonshme është të mendosh se epoka e dëshmorëve i përket vetëm së kaluarës. Në realitet, koncepti i sakrificës për atdheun vazhdon të jetë i gjallë edhe sot, në forma të reja dhe në kontekste të ndryshme.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë një dëshmi e kësaj vazhdimësie. Që prej anëtarësimit në NATO, Shqipëria ka marrë përgjegjësi të reja në kuadër të sigurisë kolektive. Usharakët shqiptarë kanë shërbyer në misione ndërkombëtare në zona të vështira dhe shpesh të rrezikshme.

Në këto misione, disa prej tyre kanë rënë në krye të detyrës. Ata janë dëshmorët e kohës moderne, bij të Shqipërisë që sakrifkuan jetën jo vetëm për mbrojtjen e vendit, por edhe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Këta dëshmorë nuk e ndryshojnë thelbin e sakrificës; ata



e zgjerojnë atë. Nga mbrojtja e territorit, te kontributi për një botë më të sigurt.

USHTRIA SHQIPTARE, NDËRMJET TRADITËS DHE MODERNIZIMIT

Në thelb të çdo ushtrie qëndron një parim i thjeshtë, por i fuqishëm: shërbimi ndaj atdheut. Për Ushtrinë Shqiptare, ky parim është i lidhur ngushtë me historinë e saj dhe me figurën e dëshmorit.

Sot, Forcat e Armatosura janë në një proces të vazhdueshëm modernizimi, duke u përshtatur me standardet e aleancave ndërkombëtare dhe me sfidat e reja të sigurisë. Por pavarësisht teknologjisë, strukturave dhe doktrinave të reja, një element mbetet i pandryshuar: gatishmëria për sakrificë.

Dëshmorët e Ushtrisë janë prova më e qartë se ky institucion nuk është thjesht një mekanizëm mbrojtës, por një strukturë që mbart vlera të thella morale. Ata përfaqësojnë kulmin e përgjegjësisë ushtarake – momentin kur detyra vendoset mbi jetën.

KUJTESA AKTIVE, PËRTEJ CEREMONIVE

Kujtesa për dëshmorët duhet të jetë aktive dhe funksionale. Ajo duhet të reflektohet në mënyrën si ndërtojmë institucionet, si edukojmë brezat dhe si trajtojmë

njëri-tjetrin si shoqëri.

Të nderosh dëshmorët do të thotë: të mbrosh ligjin dhe drejtësinë; të refuzosh korrupsionin dhe padrejtësinë; të kultivosh respekt për sakrificën dhe për historinë.

Sepse dëshmorët nuk ranë për një ide abstrakte, por për një Shqipëri më të mirë.

BREZAT E RINJ, MIDIS HARRESËS DHE PËRGJEGJËSISË

Brezi i ri jeton në një realitet krejt ndryshe nga ai i dëshmorëve. Ai nuk e ka përjetuar luftën, sakrificën ekstreme apo mungesën e lirisë në të njëjtën mënyrë.

Kjo krijon një distancë, por edhe një sfidë, si ta bëjmë kujtesën të kuptueshme dhe të vlefshme për një brez që jeton në një botë globale dhe digjitale?

Përgjigjja nuk qëndron në imponim, por në edukim dhe shembull. Patriotizmi sot nuk është vetëm çështje emocioni, por edhe çështje veprimi. Ai shfaqet në integritetin profesional, në respektin për ligjin, në kontributin për shoqërinë.

5 MAJI, NJË PASQYRË PËR TË SOTMEN

Në një analizë të fundit, 5 Maji nuk është vetëm një ditë për të kaluarën. Ai është një instrument për të vlerësuar të tashmen.

Na detyron të bëjmë pyetje thelbësore: A po e nderojmë sakrificën me mënyrën se si jetojmë? A po ndërtojmë një shoqëri të denjë për ata që dhanë jetën? A po e ruajmë unitetin kombëtar apo po e dëmtojmë atë me përçarje të panevojshme?

Këto nuk janë pyetje retorike. Janë pyetje që përcaktojnë drejtimin e një kombi.

Dëshmorët nuk kërkojnë lavdi. Ata nuk kërkojnë as përkujtimore madhështore. Ajo që ata na kanë lënë është shumë më e thjeshtë dhe shumë më e vështirë njëkohësisht: një amanet.

Amaneti për të mos harruar. Amaneti për të mos e shpërdoruar lirinë. Amaneti për të qenë më të mirë se dje.

Në një botë që ndryshon me shpejtësi, ku vlerat shpesh relativizohen dhe historia rishkruhet sipas interesave të momentit, 5 Maji mbetet një pikë e qëndrueshme. Një ditë që na rikthen te thelbi.

Përkulja para dëshmorëve nuk është një akt formal. Është një akt vetëdijeje. Është pranimi se ajo që kemi sot nuk është e rastësishme, por rezultat i një çmimi të lartë.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të Atdheut.

Nderim i veçantë për dëshmorët e Forcave të Armatosura, ata që në kohë paqeje dëshmuar se sakrifica nuk njih kohë.

Dhe përgjegjësi për ne, që historia e tyre të mos mbetet vetëm kujtim, por të bëhet udhërrëfyes.



“Lufta në Lindjen e Mesme dhe Siguria në Epokën e Krizave Hibride”

Një konferencë shkencore që solli në Tiranë debatin mbi sfidat globale dhe rolin e vendeve të vogla

Në një kohë kur bota po përballlet me tensione të shumta gjeopolitike, me konflikte të armatosura, kërcënime hibride dhe pasiguri energjetike, në Tiranë u zhvillua një nga aktivitetet më domethënëse akademike dhe strategjike të kohëve të fundit: konferenca shkencore me temë **“Lufta në Lindjen e Mesme dhe siguria në epokën e krizave hibride: Refleksione për vendet e vogla, Shqipëria si vend partner”**.

E organizuar nga Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare i Universitetit European të Tiranës, në bashkëpunim me Komunitetin Hebraik në Shqipëri dhe Institutin e Studimeve të Historisë Ushtarake, konferenca mbledhi personalitete të njohura të diplomacisë, sigurisë, akademisë dhe studimeve strategjike, duke e kthyer Tiranën në një qendër të rëndësishme reflektimi mbi zhvillimet më të fundit ndërkombëtare.

Aktiviteti u zhvillua në ambientet e Hotel Xheko Imperial dhe kishte si qëllim të analizonte transformimet e reja të sigurisë globale, ndikimin e luftës në Lindjen e Mesme dhe pozicionin që vendet e vogla, si Shqipëria, duhet të mbajnë në një rend ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks.

Konferenca u përshëndet nga figura të rëndësishme të jetës politike dhe diplomatike, ndër ta Kryeministri i Shqipërisë, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, përfaqësues të Komunitetit Hebraik në Shqipëri si edhe personalitete të larta nga Izraeli. Këto pjesëmarrje i dhanë aktivitetit jo vetëm dimension akademik, por edhe një peshë të dukshme diplomatike dhe strategjike.

Në panelin e parë, studiuesit dhe ekspertët u ndalën tek transformimi historik i Lindjes së Mesme, duke analizuar mënyrën sesi konfliktet moderne po evoluojnë nga luftëra tradicionale në përballje hibride, ku teknologjia, inteligjenca, informacioni dhe ekonomia luajnë rol po aq vendimtar sa edhe armët.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi trajtoi evolucionin gjeopolitik të rajonit që nga Lufta e Parë Botërore deri në ditët tona, duke theksuar se tensionet aktuale nuk janë ngjarje të izoluara, por vazhdimësi e proceseve të gjata historike. Ndërsa docent Sami Neziri solli një analizë të thelluar mbi kalimin nga luftërat “proxy” drejt përballjeve direkte dhe ndikimin që programi bërthamor e balistik iranien ka në ekuilibrat globalë.

Një tjetër moment me interes ishte analiza e Prof. asoc. dr. Blendi Lamit mbi strategjitë e vendeve të vogla në kohë krizash. Në kumtesën e tij ai theksoi rëndësinë e fleksibilitetit strategjik, diplomacisë aktive dhe orientimit të qartë euroatlantik për shtete si Shqipëria, të cilat duhet të dinë të



ruajnë sigurinë kombëtare në një botë të paqëndrueshme.

Paneli i dytë e zgjeroi debatin drejt çështjeve të sigurisë energjetike, mbrojtjes civile, inteligjencës dhe perceptimit publik mbi konfliktet moderne. Ekspertët evidentuan se luftërat e sotme nuk zhvillohen vetëm në fronte ushtarake, por edhe në ekonomi, informacion, teknologji dhe psikologjinë kolektive të shoqërive.

Dr. Geron Kamberi trajtoi lidhjen mes konfliktit në Lindjen e Mesme, sigurisë energjetike dhe gjeoekonomisë, duke vënë në dukje ndikimin që tensionet ndërkombëtare kanë mbi ekonominë e vendeve të vogla. Gjeneral Brigade në rezervë Albert Mullai dhe dr. Alban Rreli diskutuan rëndësinë e mbrojtjes civile dhe të infrastrukturës kritike si elementë kyç të sigurisë moderne.

Një interes të veçantë ngjalli edhe kumtesa e Dr. Gledis Nano mbi rolin e inteligjencës në konfliktet moderne, ku u theksua se informacioni dhe analiza strategjike janë bërë armë po aq të rëndësishme sa fuqia ushtarake tradicionale.

Ndërkohë, Prof. Dr. Kristaq Xharo solli një reflektim krahasues mbi marrëdhëniet Shqipëri–Izrael, duke analizuar

sfidat gjeopolitike dhe mbijetesën e vendeve partnere në një rajon të trazuar.

Ajo që e bëri këtë konferencë veçanërisht të rëndësishme ishte ndërthurja mes historisë, diplomacisë, sigurisë dhe zhvillimeve aktuale globale. Në një periudhë ku krizat ndërkombëtare kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në jetën e vendeve të vogla, aktiviteti shërbeu si një platformë serioze reflektimi dhe orientimi strategjik.

Konferenca tregoi qartë se Shqipëria nuk mund të qëndrojë jashtë debateve globale të sigurisë, por duhet të jetë pjesë aktive e tyre përmes diplomacisë, bashkëpunimit ndërkombëtar, investimit në dije dhe forcimit të institucioneve strategjike.

Në përfundim, aktiviteti la mesazhin se siguria në shekullin XXI nuk është më vetëm çështje kufijsh apo ushtrish, por një sfidë shumëdimensionale që kërkon vizion, dije, koordinim institucional dhe partneritete të qëndrueshme ndërkombëtare.

Kjo konferencë ishte më shumë se një takim akademik; ajo ishte një thirrje për reflektim mbi të ardhmen e sigurisë globale dhe mbi rolin që Shqipëria duhet të luajë në një botë që ndryshon me ritme të shpejta.



MGA SAKIP CAMI

BUQETË LULEGJAKU

(Poezi kushtuar ushtarakëve dëshmorë)



Ju qoftë falë dheu i tokës mëmë!

Dëshmorit të Atdheut Sefedin Tomçini

Ti atë ditë kishe ditëlindjen
Të përcolli Zana me dritë në sy
Ti e përshëndete me dorën lart
Do të vij e dashur, do të vij.

Ti atë ditë kishe fluturim
Dhe Zana ndjente një gulç në kraharor
Fluturimi për ty ishte rutinë
Por vajzat e vogla qanin në kor.

Do të vijë babi, do të vijë
Do të vijë për mua dhe për ju
Do të fluturojë për Shqipërinë
Në mbrëmje do të jetë këtu

O Sefe, të thërrisnin shokët
Dhe ti buzëqeshje si askush si ti
Se dashurinë për njerëzit
E kishe në gen, e mbaje në sy.

Fluturove mbi Lushnje, mbi Adriatik
Mbi tokën arbërore që e dashuroje
Defekti i mallkuar ndodhi me vërtik
Ndaj qytetin dhe njerëzit ti do t'i mbroje

Do t'i mbroje duke sakrifikuar
Jetën tënde duke bërë sublim
Jetën e doje, jetën e mbrojte
Në të fundit, tëndin fluturim.

Dhe mbete në qiell, në përjetësi
Toka arbërore të mori në gji
Që Ti të prehesh pranë nënës
Nënës në madhe Shqipëri.



Majorit dëshmor Klodian Tanushi
(Ra në krye të detyrës në një mision ushtarak të NATO-s)

Ti u rrite me kapelën e babait mbi krye
U rrite me kangët e trimërisë
U rrite rrëzë Korabit dhe buzë Drinit
Gjëmimet e tyre, pjesë e historisë.

Kur kthehej babai nga shërbimi
"O babi, babi Basri"
Pse u vonove kaq shumë?
Pse vjen kaq rrallë në shtëpi?

Në prehrin e babait kërkonte shpjegim
Ç' kuptim të shenjtë kishte detyra
Pa ditur se dhe ai një ditë me gëzim

Do të shkonte ku do ta thërriste detyra.

Major babai, major i biri
Renditur në ushtri si zinxhiri
Basriu luftonte mos shkelej kufiri
Klodiani në NATO më i miri.

Eh, ndryshuan kohët, por jo shqiptaria
Majori shqiptar Klodian Tanushi
Në kuadër të NATO-s u nis me detyrë
Në krye të grupit detyrën e përmbushi.

Misioni ishte i vështirë
Fusha e minuar sa më s'ka
Duke çminuar, fshehur një minë
I mori jetën, por jo shqiptarinë.

Jo vetën Shqipëria, por dhe Letonia
Të mbajnë në zemër, s'të harrojnë kurrë
Ti derdhe gjakun për një botë më të mirë
Nënat të mbështollën me flamur.

Prehu pranë Nënës Shqipëri
Prehu ti, dëshmor i Atdheut
Emrin tënd mban një shkollë
Emrin tënd s'e harron Mëmëdheu.



Dëshmorit të Atdheut Florian Delia

Fluturon shqipja mbi Korab
Nuk asht shqipe, asht Floriani
Fluturon përmbi fshat
Fluturon ku e thërret vatani.

Dalin nxënësit në oborr
Fluturon Florian Delia
Të gëzuar duart lart
Eja Flori, eja ke shpia.

Nuk e joshi pasuria
As sterlina dhe Anglia
Kur thërret zëri i Atdheut
Mbi të gjitha Shqipëria.


Kapiteni Florian Delia
Dhe togeri Donald Hoxha
Ma të mirët aviatorë
U besuan në mision.

Nuk i trembi vështirësia
Nuk i trembi mali i thepisur
Aksidenti i mallkuar
Ua ndërpreu rrugën e nisur.

Mbahu Jahe, mbahu babë
Mbahu nuse, mbahu nanë
Mbahu ti o mor Korab
Se Floriani asht ngjit lart.

Pranë tokës, pranë dheut
Që u mëkoi si heronj
Pranë bustit të Skënderbeut
Ju u shpallët dëshmorë të Atdheut.

Kapiteni Florian Delia
Ti do të rrosh sa Shqipëria
Kapiteni Florian Selmani
Ti do të rrosh sa Vatani.



Dëshmorit Hilmi Hasan Alimani
(1938-1958), Bllacë, Dibër
Rënë në krye të detyrës si ushtar kufitar në Qafën e Ali Çelës, Tropojë më 1958, ngriu në dëborë.

GURI I KUFITARIT

Është një vend në malin e Jezercës
Ku shkëmbi është gërryer
në formën e ushtarit
Me automatik në dorë.

Është një vend në malin e Jezercës
Ku kufitari ngriu një ditë janari
në formën e këtij shkëmbi
Dhe nuk shkriu, por ndrit si qelibari.

Është një vend në malin e Jezercës
Ku kufitari ngriu një ditë janari
Dhe nuk u shkri kurrë
Njerëzit i thonë: Guri i kufitarit.

Shqiponjat dibrane
(Dy pilotëve dibranë Sabri Toçi dhe Armando Gjoka që ranë në krye të detyrës, më 29 mars 1980)

Ajo ditë marsi me shi e stuhi
Ju gjeti ju në fluturim, në qiell
Për ju nuk kishte të ndalur
Për ju kishte vetëm diell.

Sabri Toçi dhe Armand Gjoka
Një nga dyshet aviatorë
Fluturuan mbi Atdhe
Porsi yje, si meteorë.

Armando lindur në Tiranë
Kurrë s'harroi Okshtunin e tij
Vinte shpesh me babanë
Drejt Dibrës fluturim.

Sabri Toçi nga Maqellara
Deri në palcë atdhetar
Më i miri aviator
Aviator i klasit të parë.

Në stërvitjen e vështirë
Reaktivi nuk u bind
Manovrim pas manovrimi
Në përpjekje për shpëtim.

Për ta mbrojtur
Shmangën qytetin
Për të mos humbur
Shmangën dhe detin.

Toka i mori në gjirin e saj
Lotoi qielli i tmerruar
Nënat hapën krahët
Për t'i përqaftuar.

Dhe mbetët tek Nëna
Ju përjetësisht
Lartësohet kënga
Himn, madhërisht.



“ZONJA E KLOSIT – GRUAJA QË SFIDOI KOHËN DHE PERANDORINË”



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Në përkujtim të luftëtares së shquar labe, të Zonjës së Nivicës dhe zonjës së Klosit në Mallakastër, gruas së hekurt që krijoi fshatin Klos dhe i dha dimension jetës në trevën mallakastriote, zonjës që jetoi gjatë edhe në monument të hekurt në hyrje të rrugës së Klosit në bazament të gurtë, Zonjës që pritet të ringrihet për historinë që shkroi, për gjakun e sakrificat e mbijetesës shqiptare në shekuj.

Në rrëfenjat e shumta të trevave të Jugut, të Labërisë, të Mallakastrës, e zonave përreth tyre, atje ku era përplaslet me shpatet e majmëmaleve të Nivicës, Këndrevicës, Kurveleshit, Bylysit, Amanties, Beunit,..., dhe kujtesa endet mes historisë e legjendës, lindi figura e një gruaje që koha nuk e zbehu kurrë: zonja e Nivicës, që u bë edhe zonja e Klosit. Ajo luftoi me hordhitë osmane për vite me radhë në periudhën pas vdekjes së heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit.

Gjithë Labëria është e mbushur me ngjarje historike, me luftëra patriotike dhe heroizma të pashoqe, ku, përveç burrave, janë shquar dukshëm edhe gratë. Edhe sot në Labëri kujtohet ajo figurë që tashmë është tipizuar dhe është trupëzuar në histori: “Zonja e Nivicës, që u bë edhe zonja e Klosit”. Lufta njëzetvjeçare e Labërisë me osmanët përfundoi me “venomet”, pra me vetadministrimin krahinor të Labërisë, me kryeqendër Himarën dhe 56 fshatra të tjerë. Kënga është trashëguar në shekuj: “Jemi këtu në vendin tonë, /që pa lerë diell e hënë...”. Në Labëri, Mallakastër e kudo në trevat shqiptare, figurat e shquara dhe historitë luftarake janë me bollëk; edhe kur lëngonte nga zgjedha e huaj Shqipëria, gjithmonë zgjohej Labëria, zgjohej shqiptaria. Prandaj edhe historia e zonjës labe të Nivicës, e më tej edhe e zonjës së Klosit, është kaq domethënëse. E ardhur nga Nivica e Kurveleshit, Zonja bashkë me shpurën që e shoqëronte, kapërceu lumin Vjosë dhe mbërriti në “portat” e Mallakastrës rreth pesë shekuj më parë, duke sjellë me vete jo vetëm një prejardhje të një trashëgimie të fortë, por një shpirt të pathyeshëm që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në trojet ku banoi, punoi e luftoi dhe ku vendosi rrënjët e fshatit Klos. Nga burra të mocëm dhe të mençur kemi mundur të mësojmë një histori të rrallë: “Jetonte dikur para më shumë se gjysmë mijëvjeçari në Nivicë një Zonjë, grua burrneshë e fjalës, e veprës, e besës dhe që nuk ia hante qeni shkopin në punët e malit dhe të fushës. Emri i saj kishte kaluar që kur ishte e re kufijtë e fshatit Nivicë dhe të Kurveleshit, për ndershmëri, zgjuarsi e trimëri. Legjenda përcillet shekujve për të si një krijesë e malësisë së jugut, që nuk e ndante jataganin nga vetja. Shtëpinë e kishte si saraje në Nivicë me disa shërbëtorë besnikë, që e ndiqnin në luftë kundër osmanëve dhe në mbajtjen e derës së hapur për miqësi, por në lartësi të maleve tokën e kishin me kursim. Jetonin me blegtori dhe me shkëmbime të produkteve, ndërkohë edhe taksidarët osmanlinj dukeshin sa herë vinte stina e të vjelave për “të dhjetat”. Në dokumentet e kohës periudha 1472-1492 shënon një kohë të rëndësishme qëndrese pas vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, ku Labëria, Mallakastra dhe krahina të tjera shqiptare luftuan kundër pushtimit osman, duke fituar në disa raste të drejta vetëqeverisjeje ose siç quheshin dikur “venome”/ (vetëqeverisje), ku trupat pushtuese osmane u detyruan të jepnin pas rezistencës dhe përballjes së përgjakshme në trevën kaonike dhe që njihen si “Venomet e Himarës”, më saktë “venomet e Labërisë”, që në atë kohë përfshinte 56 fshatra, deri në afërsi të Beratit. Në shënjestër të pushtuesit ishte vënë dhe Zonja me gjithë tarafin e saj, por për t’i shpëtuar koshareve osmane, Zonja mori gjithë fisin e saj, shërbëtorët dhe gjënë e gjallë dhe nisi shtegtimin në drejtim të vendeve “të buta”, kaloi Vjosën në grykën e Poçemit dhe ndalesën e parë e bëri në brigjet e vendbanimit të hershëm ilir në faqen e kodrinave të Bylysit e Hekalit, dhe vendin që e zgjodhi e quajti “Klos”. Pas dy vitesh qëndresë meqenëse i shoqi kishte humbur jetën larg në Jemen (një ndër skajet e Perandorisë Osmane), kur kryente shërbimin e detyrueshëm ushtarak shtatë vjeçar, për këtë në vend të tij në familje erdhi mandata/fermani, një ferman i shkruar me germa arabe: “...

Legjenda e Burrneshës së Labërisë dhe Mallakastrës



Vatanina hizmet ederken hayatını kaybettiler” (“humbi jetën në shërbim të Atdheut”). Zonja u pikëllua por nuk e dha veten. Jeta do të vazhdonte. Brez pas brezi e kanë treguar Zonjën e Klosit si një grua me tipare burrërore, jo vetëm në pamje, por mbi të gjitha në karakter. Sytë e saj nuk njihnin frikë, ecte me hapa të rëndë dhe e vendosur si një prijëse që dinte mirë t’i jepte drejtim jetës dhe fatit. Në një kohë kur historia shkruhej kryesisht nga burrat dhe për burrat, ajo guxoi të dilte përtej kufijve të zakonshëm, duke u bërë jo vetëm pjesë e saj, por edhe një ndër faqet më të veçanta të saj dhe vend origjinën e saj janë të njohura përveç burrave edhe Zonjat e Mëmëzonjat. Zonja e Nivicës, siç njihet në vendlindje, u përball me dallgët e pushtimit osman, një periudhë e mbushur me trazira, përplasje dhe sfida të mëdha për popullsitë vendase.

Ajo nuk ishte një figurë që fshihej pas mureve apo që i dorëzohej fatit, por përkundrazi, ishte një luftëtare që e përballonte rrezikun dhe e shikonte jetën në sy, por edhe njerëzit i shikonte në sy dhe “i përpinte” me shikimin e mprehtë dhe që dinte të lexonte edhe mendimet e tyre. Zonja ishte në gjendje të ngjishte armët dhe të qëndronte në vijën e parë, duke u përballur me pushtuesit me një guxim që frymëzonte dhe luftëtarët burra. Me të drejtë fshati e krahina e quanin burrneshë.

Fakt është se madhështia e saj nuk qëndronte vetëm në trimëri, por edhe në vizionin për të ardhmen për vijueshmërinë e jetës. Përtej lumit të Vjosës ngjitur me Labërinë e Saj në trojet e ilire të Bylysit, të zonës së Mallakastrës, aty ku më vonë do të lindte fshati Klos, ajo parashikoi dhe hodhi themelet e dy lagjeve që do të bëheshin vatër jete, lufte dhe qëndrese. Tashmë me të drejtë quhej zonja e Klosit, pasi me duart, mendjen e saj të mprehtë dhe me një vendosmëri të rrallë, ajo ndërtoi jo vetëm shtëpi të gurta, por dy mëhalla të njohura në Klos dhe në mbarë Mallakastrën. Klosi ka qenë gjithmonë një oxhak i madh, një vatër zjarri nga një bashkësi njerëzish që trashëgonin truallin, jetën e rilindur por dhe frymën e saj të pathyeshme. Me kalimin e kohës, Zonja e Nivicës u shndërrua në Zonjën e Klosit. Ky shndërrim nuk ishte thjesht një ndryshim emri, por një kurorëzim i një jete të jetuar me dinjitet, sakrificë e trimëri, pasi ajo u bë simbol i vendit, një figurë që përfaqësonte qëndresën, guximin, krenarinë e një populli që nuk pranonte kurrësi nënshtrimin. Historia e saj shkon përtej mureve të kujtesës, përtej dekadave e shekujve, e megjithëse e mbështjellë me mjegullën e legjendës, ka mbijetuar për mbi 500 vjet. Ajo është përcjellë brez pas brezi, në oda burrash, në oda me qelqe dhe jo vetëm, si rrëfenja familjare, duke u bërë

pjesë e identitetit të krejt zonës. Si çdo histori të madhe, ajo nuk është vetëm një kujtim i së shkuarës, por një frymëzim për të ardhmen, është nderim për këtë figurë të jashtëzakonshme, pasardhësit e saj ngritën një monument madhështor metalik hyjnor dhe të shenjtëruar, rreth katër metra të lartë, në hyrje të rrugës që të çon drejt fshatit Klos. Ai monument nuk ishte thjesht një strukturë e metaltë e ngritur në një bazament guri solid si vetë njerëzit e këtij vendi, por është një dëshmi e gjallë e mirënjohjes, kujtesës së përhershme kolektive të unifikuar për një grua që sfidoi kohën dhe rregullat e saj. Me forcën e saj të vullnetit ngriti dhe përforcoi rregulla kanunore që përfshihen në të drejtën zakonore labe dhe asaj mallakastriote.

Në kushtet ku Zonja kishte humbur të shoqin në shërbimin e gjatë ushtarak osman (thuhet në Jemen), kushtet e detyruan që të martohej me kryeshërbëtorin e saj. Ajo solli në jetë dy djem. Djemtë u rritën dhe edukuan me zakonet e vendit, por pa harruar kurrë origjinën, traditat dhe zakonet. Ata u bënë të zotë në përballimin e punëve në mal dhe në fushë, por edhe në përgatitje luftarake që ishte zanat i shqiptarëve që trashëgohej në çdo familje. Falë autoritetit që Zonja gëzonte edhe djemtë i ndau që njeri të ishte në mal me bagëti dhe tjetri në fushë ku kishte tokë por edhe ujë. Djemtë ndoqën këshillën e Zonjës, njëri në Mëhallën e Shkëmbit në Bylis dhe tjetri në Mëhallën fushore në “Çalliaj” në Klos. Meqenëse Mëhalla e Shkëmbit kishte vështirësi të mëdha me blegtori që produktet i shkëmbenin me ata të fushës, u detyruan që një pjesë e tyre të vendoseshin në fshatin Dukat të Vlorës për një jetë më të mirë, pasi tradicionalisht ka ngelur një maksimumë proverbiale popullore “pranë detit pranë mbretit”. Kështu djemtë e “Mëhallës së Shkëmbit” u bënë dukatas të mirë dhe ngritën vatra e oxhakë të rinj në Dukat edhe sot mbajnë të njëjtin mbiemër me banorët e Klosit të Mallakastrës e deri të Nivicës së Kurveleshit.

Nga të gjithë të dhënat, Zonja e Klosit mbetet një figurë mitike, por reale në kufijtë e historisë, por edhe të legjendës, aty ku e vërteta përziehet me rrëfimin dhe krijon një realitet më të madh dhe të qëndrueshëm si edhe vetë faktet. Zonja e Klosit është një simbol i forcës femërore, një dëshmi se guximi nuk njih gjini dhe se një individ i vendosur mund të ndryshojë rrjedhën e histories, por edhe mund të shkruajë histori të qëndrueshme dhe që jeton gjatë.

Kushdo që kalon përbri Klosit buzë rrugës së këtij fshati me emër në rrugën nacionale që të çon nga Fieri në Gjirokastrë, do të kujtojë se këtu ngjitur me Poçemin historik të tre Kuvendeve, ku era fryn mbi rrugët e Klosit, prek gurët e vjetër të shtëpive, bile edhe lugina dhe ujërat e lumit Vjosa duken sikur pëshpëritin emrin e saj “Zonja labe e Klosit”.

Nga të dhënat brez pas brezi në Klos pasardhësit e Zonjës, për nder të saj ngritën edhe një memorial metalik kushtuar Zonjës rreth katër metra të lartë. Kohët ndryshuan dhe në vend të tyre koha solli në skenë memoriale të rinj të luftës dhe të punës, por Zonja e Klosit nuk u harrua kurrë. Memoriali ishte vendosur pranë hyrjes së rrugës aktuale në drejtim të fshatit Klos, përbri rrugës nacionale, në këmbët e qytetit antik të Nikajës, ku dëshmitë historike rrënojat e teatrit, stadiumit dhe mureve rrethuese jetojnë bashkë me historinë e antikitetit shqiptar. Nuk është e rastit që edhe Zonja e Kurveleshit përzgjedhi një vend të përshtatshëm si qyteti antik i Nikajës. Ndërkohë epoka evoluon edhe për Klosin, jeta rrjedh si ujë e Vjosës, kujtimet ngelen, historia tregohet në breza. Fakt është se ish-Zonja e Nivicës që u bë Zonja e Klosit, zonjë që jetoi, jeton e do të jetojë, jo vetëm në monumentin që meriton të ringrihet, por në kujtesën kolektive të një populli në dy krahina fisnike në Labëri dhe në Mallakastër, që nuk harron ata që e bënë historinë me shpirt, me gjak, me sakrificë të mëdha, nuk harron kurrë identitetin arbëror e vijueshmërinë e shpirtit shqiptar, që e lartësojnë më shumë shqiptarizmin.

Studimi që rishkruan historinë e shqiptarëve

Zbulimi i ‘Nature’: ADN-ja shqiptare ruan vazhdimësinë e Epokës së Bronzit

Revista shkencore “Nature Human Behaviour” ka publikuar një studim revolucionar që ndriçon origjinën gjenetike të shqiptarëve, duke konfirmuar se ata janë pasardhës të drejtpërdrejtë të një grupi të lashtë paleo-ballkanik që ka ruajtur vazhdimësi të jashtëzakonshme që nga Epoka e Bronzit e vonë dhe Epoka e Hekurit. Ky zbulim, i bazuar në analizën e mbi 6,000 gjenomeve të lashta dhe 74 shqiptarëve të sotëm, përbën një nga studimet më të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar.

Çfarë zbuloi studimi i “Nature”

- Vazhdimësi gjenetike e rrallë: ADN-ja e shqiptarëve të sotëm tregon një lidhje të drejtpërdrejtë me popullsitë e Ballkanit Perëndimor të Epokës së Bronzit dhe Hekurit, veçanërisht në territorin e Shqipërisë së hershme.

- Datimi i hershëm: Rreth 800–900 pas Krishtit, profili gjenetik i banorëve të Shqipërisë së Mesjetës së hershme ishte tashmë shumë i ngjashëm me atë të shqiptarëve modernë.

- Përzierje e kufizuar: Vetëm 10–20% e përbërjes gjenetike vjen nga grupe të Evropës Lindore të Mesjetës, duke treguar ndikime të kufizuara nga migrimet e mëvonshme.

- Metoda e avancuar: Studiuesit përdorën një protokoll të ri për të zbuluar segmente “identity-by-descent” – lidhje të drejtpërdrejta mes individëve të lashtë dhe atyre të sotëm – që lejuan ndërtimin e një harte të saktë të vazhdimësisë gjenetike.

Rëndësia për historinë dhe gjuhën shqipe

Ky studim i jep një bazë shkencore debatit shumëvjeçar mbi origjinën e shqiptarëve dhe gjuhës shqipe.

- Gjuha shqipe del si trashëgimi e një grupi të lashtë paleo-ballkanik, e cila ka mbijetuar pavarësisht ndikimeve të shumta kulturore dhe politike në rajon.

- Shqiptarët paraqiten si një popull që ka ruajtur identitetin e vet biologjik dhe kulturor për më shumë se tre mijë vjet, duke qenë një nga grupet më autoktone të Evropës.

Komentet e studiuesve

Autorët e studimit – mes tyre Leonidas-Romanos Davranoglou, Gjergj Bojaxhi, dhe Alban Lauka – theksojnë se rezultatet “hedhin dritë mbi proceset demografike që kanë formuar trashëgiminë shqiptare” dhe ndihmojnë në “lokalizimin e zonës së origjinës së gjuhës shqipe”.

Ekspertë ndërkombëtarë e kanë cilësuar këtë si një moment historik për antropologjinë ballkanike, pasi për herë të parë ADN-ja e lashtë konfirmon vazhdimësinë e një populli që ka qenë shpesh i rrethuar nga migrime dhe pushtime.

Studimi i “Nature” konfirmon se shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të popullsive të lashta ballkanike, duke ruajtur një vazhdimësi gjenetike që i dallon nga fqinjët e tyre. Ky zbulim jo vetëm që forcon identitetin historik të shqiptarëve, por edhe ndihmon në kuptimin e rrënjëve të gjuhës shqipe – një degë unike e familjes indoevropiane që ka mbijetuar për mijëra vjet.

Ku u zhvilluan studimet

Mbretëria e Bashkuar – Universiteti i Oksfordit (Oxford University Museum of Natural History): Drejtuesi kryesor i projektit, Leonidas-Romanos Davranoglou, analizoi gjenomet e lashta të Ballkanit Perëndimor dhe krahasoi ADN-në e shqiptarëve modernë me popullsitë e Epokës së Bronzit dhe Hekurit.

Hungari – Universiteti i Szegedit: Laboratori i biologjisë molekulare i drejtuar nga Zoltán Maróti përpunoi pjesën më të madhe të të dhënave të ADN-së së lashtë nga rajoni i Ballkanit dhe Evropës Perëndimore.

Shqipëri – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Studiuesit Ardian Muhaj dhe Ilia Mikerezi bashkëpunuan në mbledhjen e mostrave dhe interpretimin e të dhënave për popullsinë shqiptare, duke siguruar përfaqësim të gjerë gjeografik nga veriu, qendra dhe jugu i vendit.

SHBA – Universiteti Shtetëror i Ohajos (Ohio State University): Gjuhëtari Brian D. Joseph kontribuoi në analizën e lidhjes midis gjenetikës dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, për të kuptuar origjinën e saj si degë e veçantë indoevropiane.

Qipro – European University Cyprus: Alexandros Heraclides ndihmoi në modelimin statistik të përzierjeve gjenetike mes popullatave të lashta dhe moderne.

Çfarë përfshinte kërkimi

- Analizë e mbi 6 000 gjenomeve të lashta nga Evropa Perëndimore dhe Ballkani.

- 74 mostra të reja ADN-je nga shqiptarë të sotëm, të mbledhura me pëlqimin e pjesëmarrësve.

- Përdorimi i metodës *ancient identity-by-descent* (ancIBD) për të identifikuar segmente të trashëguara drejtpërdrejt nga



Parku Arkeologjik Lezhë

paraardhësit e lashtë.

- Krahasimi i ADN-së shqiptare me popullsitë e Epokës së Bronzit dhe Hekurit në rajonin e Dardanisë, Ilirisë dhe Epirit.

Studimi konfirmon se shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të popullsive paleo-ballkanike, me vazhdimësi gjenetike që nga Epoka e Bronzit dhe ndikime të kufizuara

nga migrimet mesjetare lindore (10–20%).

Ky rezultat u arrit përmes bashkëpunimit ndërmjet laboratorëve të Oksfordit, Szegedit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke e vendosur Shqipërinë në qendër të kërkimeve moderne mbi origjinën e popujve të Ballkanit.

Burimi: Nature Human Behaviour



Roli thelbësor i teknologjisë në formësimin e pushtetit global

Koncepti i pushtetit global ka pësuar një ndryshim thelbësor. Nuk është më vetëm fuqia ushtarake apo pasuria ekonomike që përcakton rëndësinë dhe ndikimin e një shteti apo organizate ndërkombëtare, por edhe aftësia për të zotëruar, zhvilluar dhe përdorur teknologjitë më të avancuara. Teknologjia ka depërtuar në çdo aspekt të jetës dhe politikës ndërkombëtare, duke u bërë një faktor kyç që formëson balancën e fuqisë, strategjitë e sigurisë dhe mënyrën se si shtetet ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

Në këtë kontekst, teknologjia nuk është më thjesht një mjet ndihmës, por një element thelbësor që përcakton pozicionin dhe ndikimin në arenën globale. Ajo ndikon në inovacion, sigurinë kibernetike, menaxhimin e informacionit, rivalitetin ndërkombëtar, si dhe në pasojat shoqërore që rrjedhin prej këtyre proceseve. Ky shkrim do të eksplorojë mënyrat se si teknologjia ka transformuar konceptin e pushtetit, duke u fokusuar në inovacionin, sigurinë kibernetike, informacionin, rivalitetin global dhe pasojat shoqërore, duke sjellë shembuj konkretë për secilën fushë.

Inovacioni teknologjik si avantazh strategjik

Shtetet që investojnë në inteligjencën artificiale, bioteknologjinë dhe energjinë e rinovueshme kanë një avantazh të madh në arenën ndërkombëtare. Për shembull, SHBA dhe Kina kanë investuar miliarda dollarë në zhvillimin e inteligjencës artificiale, duke krijuar sisteme që ndryshojnë mënyrën e luftës, ekonomisë dhe jetës së përditshme. Kjo garë inovacioni nuk është vetëm për teknologji, por për ndikimin që ato kanë në mënyrën se si funksionon shoqëria.

Siguria kibernetike: Mbrojtja e hapësirës digjitale si element kyç i pushtetit

Në një botë ku informacioni rrjedh nëpër rrjete digjitale, kontrolli dhe mbrojtja nga sulmet kibernetike janë jetike. Një sulm kibernetik mund të paralizojë infrastrukturën kritike të një shteti, siç ndodhi me sulmin ndaj Ukrainës në vitin 2017, ku rrjetet elektrike u goditën nga hakerë të lidhur me aktorë shtetërorë. Kjo tregon se pushteti nuk është vetëm në fushën fizike, por edhe në atë virtual.

Informacioni dhe ndikimi në opinionin publik

Teknologjia e komunikimit dhe rrjetet sociale u japin shteteve mundësinë të formësojnë opinionin publik dhe të ndikojnë në politikën ndërkombëtare. Një shembull i qartë është përdorimi i mediave sociale gjatë zgjedhjeve presidenciale në SHBA në vitin 2016, ku u përdorën teknika të avancuara për të shpërndarë dezinformata dhe për të ndikuar në votuesit.

SHBA dhe Kina: Dy superfuqitë në garë për teknologjinë e së ardhmes

SHBA dhe Kina janë dy aktorët kryesorë në garën për dominim teknologjik. Kina ka investuar në mënyrë agresive në teknologji si 5G, inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e gjurmimit biometrik, ndërsa SHBA vazhdon të jetë lider në inovacion dhe zhvillim të teknologjive të avancuara. Ky rivalitet ka ndikime të mëdha në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në ekonominë globale.

Bashkimi Evropian: Ruajtja e autonomisë digjitale dhe mbrojtja e të dhënave

Bashkimi Evropian ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të mbrojtur të dhënat e qytetarëve dhe për të ruajtur pavarësinë teknologjike. Rregullorja GDPR është një shembull i qartë i përpjekjeve për të vendosur standarde të larta në privatësinë dhe sigurinë e të dhënave.

Shtetet e vogla dhe specializimi teknologjik

Edhe vendet më të vogla mund të fitojnë ndikim në arenën globale përmes specializimit në fusha të caktuara teknologjike. Për shembull, Estonia është bërë një model në qeverisjen digjitale dhe sigurinë kibernetike, duke u bërë

Teknologjia dhe Pushteti



Shtetet që investojnë në inteligjencën artificiale, bioteknologjinë dhe energjinë e rinovueshme kanë një avantazh të madh në arenën ndërkombëtare. Për shembull, SHBA dhe Kina kanë investuar miliarda dollarë në zhvillimin e inteligjencës artificiale, duke krijuar sisteme që ndryshojnë mënyrën e luftës, ekonomisë dhe jetës së përditshme.

një shembull për vendet e tjera në Balltik.

Ndikimi në ekonominë globale dhe krijimi i industrive të reja

Teknologjia ka ndryshuar rrënjësisht ekonominë, duke krijuar industri të reja si ekonomia digjitale, fintech dhe energjia e rinovueshme. Kjo ka sjellë mundësi të reja punësimi, por edhe sfida si pabarazitë ekonomike dhe zhdukja e disa profesioneve tradicionale.

Transformimi i shoqërisë dhe mënyrës së komunikimit

Rrjetet sociale dhe platformat digjitale kanë ndryshuar mënyrën se si njerëzit komunikojnë dhe ndërveprojnë. Nga shembulli i përdorimit të TikTok për përhapjen e kulturës popullore deri te përdorimi i WhatsApp për komunikim në kohë reale, teknologjia ka krijuar një botë më të lidhur, por edhe më komplekse.

Pushteti politik dhe teknologjia

Shtetet me kapacitet teknologjik kanë më shumë fuqi për të imponuar politika ndërkombëtare dhe për të ndikuar në vendimmarrje globale. Teknologjitë e mbikëqyrjes dhe analizës së të dhënave u japin qeverive mjete të reja për kontroll dhe ndikim.

E ardhmja e pushtetit në epokën teknologjike

Fuqia teknologjike është bërë një nga treguesit kryesorë të pushtetit të shteteve në shekullin 21. Në të ardhmen, balanca e fuqisë globale do të varet gjithnjë e më shumë nga aftësia e shteteve për të inovuar, për të mbrojtur hapësirën digjitale dhe për të përdorur teknologjinë si mjet strategjik. Për më tepër, sfidat etike dhe sociale që vijnë me teknologjinë do të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar dhe politika të mençura për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë.



Njoftim

Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimet e kandidatëve për rezervistë dhe kërkon të rekrutojë 363 kandidatë.

Data e fillimit të stërvitjes: 1 tetor 2026.

Kategoritë që do të rekrutohen:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| ☐ Oficer rezervist | 47 (dyzetë e shtatë) kuota |
| ☐ Nënoficer rezervist | 132 (njëqind e tridhjetë e dy) kuota |
| ☐ Ushtar / detar rezervist | 170 (njëqind e shtatëdhjetë) kuota |
| ☐ Mjek / infermier rezervist | 14 (katërmëdhjetë) kuota |

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më: 31 korrik 2026